



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 159, Datë 05.05.2023

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “NOVA SOLAR SYSTEM” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 50 MW, NË ZONËN KADASTRALE 3358, FSHATI SHEQ MARINAS, BASHKIA FIER, QARKU FIER

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5, pika 1, gërma “a” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 05.05.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1319/1 prot., datë 03.05.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 50 MW, në zonën kadastrale 3358, Fshati Sheq Marinas, Bashkia Fier, Qarku Fier”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1319 prot., datë 26.04.2023, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 50 MW, me vendndodhje në Zonën Kadastrale 3358, fshatin Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); Shtojcën 1, Shtojcën 1A dhe Shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (Aneksi A).
- Apikuesi ka kryer pagesën, sipas përcaktimeve të Aneksit A “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9 për pikën 1.2, gërmat “a” dhe “d”; për pikën 1.3, gërmën “c” dhe për pikën 2, gërmat “d” dhe “e”.
- Nga ky aplikim rezulton gjithashtu se nevojitet të plotësohet dokumentacioni si vijon:

NENI 9, Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1, Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

- *Pika 1.1.*

Shoqëria duhet të depozitojë në ERE formatin e aplikimit sipas Shtojcës 1 të plotësuar në të gjithë zërat e saj.

- *Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ*

- **gërma “b”:** Shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimin e gjendjes gjyqësore për shoqërinë dhe administratorin tjetër të saj.

- **gërma “c”:** Shoqëria duhet të depozitojë në ERE strukturën organizative të saj, duke reflektuar saktësimet/ndryshimet përkatëse referuar të dhënave që rezultojnë nga ekstrakti historik i regjistrit tregtar.

- *Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal*

- **gërma “a”:** Shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimin përkatës për shlyerjen e të gjitha detyrimeve ndaj institucionit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

- **gërma “b”:** Shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentet vërtetuese të mbulimit të 20 % të vlerës së investimit.

Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

- **2.1 Shoqëria duhet të depozitojë në ERE shtojcën 2 të plotësuar.**
- **gërma “b”: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE Kontratën me MIE-n në format origjinal ose fotokopje të njësuar me origjinalin.**
- **gërma “c”: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE miratimin përfundimtar të pikës së lidhjes me rrjetin e transmetimit.**

- Gjithashtu, shoqëria duhet të bëjë me dije nëse ka filluar punimet për ndërtimin e centralit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 50 MW, me vendndodhje në zonën kadastrale 3358, fshati Sheq Marinas, Bashkia Fier, Qarku Fier.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI